



Keshilli i Bashkisë Korçë

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të
Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr.____ datë. 28/07/2025

Nr.____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimeve, relacioneve dhe dokumentave shoqërues të projekt-vendimeve, në lidhje me propozimin

- 1. Projekt-vendim (Pika 5 e rendit të ditës)** “PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 NË NIVEL PROGRAMI” **propozuar nga ekzekutivi.**
- 2. Projekt-vendim (pika 6 e rendit të ditës)** “PËR MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE NGA TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE NË VLERËN 243,812.5 LEKË DHE KRYERJEN E PAGESËS PËR KTHIMIN E SHUMËS NË PO KËTË VLERË PËR LLOGARI TË “TELEKOM ALBANIA” SH.A,(ONE TELECOMMUNICATIONS)” **propozuar nga ekzekutivi.**

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore e propozimit të projekt-vendimit dhe e vendimit të Komisionit të Përhershëm – a është i mbështetur në ligj propozimi dhe vendimarrja)

Udhezimi nr. 19 date 10.07.2025 "Per pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2026-2028", udhezimi nr. 23 date 30.7.2018 "Per proc;edurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te Njesive te Veteqeverisjes Vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 9936, date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, ligjit nr. 68, date 27.04.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", VKB nr. 172 date 26.12.2024 "Per miratimin e kalendarit te PBA 2026-2028 dhe te buxhetit vjetor 2026, Bashkia Korçe", VKB nr. 176 date 26.12.2024 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor te vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 te Bashkise Korçe", si dhe VKB nr. 20 date 25.1.2025 "Per vleresimet dhe parashikimet afatmesme te te ardhurave", ligjin nr 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", ligjin nr. 9936 date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, ligjin nr. 68 date 27.4.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", ligjin 115/2024 date 03.12.2024 "Per buxhetin e vitit 2025", udhezimin plotesues nr. 2 date 24.01.2025 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025", udhezimin nr. 9 date 20.03.2018 i Ministrise se Financave dhe Ekonomise "Per procedurat standarde te zbatimit te buxhetit" i ndryshuar, si dhe VKB nr. 176 date 26.12.2024 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor te vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 te Bashkise Korçe"

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit – nëse konstatohet që ekziston nevoja për këtë vendim të propozuar dhe çfarë problematike zgjidh ai)

Për pikën 1: Hartimi, diskutimi dhe miratimi i tavaneve buxhetore është detyrim ligjor i legjislacionit si fazë e hartimit të PBA-së përfundimtare dhe dhe buxhetit të vitit 2026.

Për pikën 2: Ka të bëjë me të drejtën e administrimit të të ardhurave si e vetmja mundësi për të kthyer një detyrim të paguar më tepër kundrejt paguesit.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet – a ka efekte në buxhet dhe a është parashikuar ap nevojitet buxhet shtesë për zbatimin e vendimit)

Pika 1: Projekt vendimi është dokumenta strategjik i cili përcakton tavanet e shpenzimeve sipas programeve të vetëqeversijes vendore.

Pika 2: Vlera e paguar më tepër nga subjekti duhet të parashikohet si shtesë të ardhurash dhe shtesë shpenzimesh për të realizuar balancimin e buxhetit.

Drejtoria / Sektori përgjegjës (kush është sektori apo drejtoria që do të ngarkohet me zbatimin)
Për pikën 1 dhe 2; Kryetari I Bashkisë dhe Drejtoria e Finances, Buxhetit dhe MFK.

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron zbatimin, raporton dhe sa shpesh)

Për pikën 1 dhe 2: Drejtoria e Finances, Buxhetit dhe MFK. Dokumenti paraqitet përsëri në këshill për miratim të draftit përfundimtar.

Impakti social / grupet që preken: (a ka efekte sociale, pozitive apo negative, grupet që preken dhe impakti që sjell vendimi)

Pika 1. Planifikim i shpenzimeve për programet buxhetore.

Pika 2: procedurë ligjore për balancim buxheti.

A është objekt i konsultimit publik: (A është projekt-vendimi subjekt i konsultimit publik në zbatim të Ligjit 139/2015?)

Pika 1: Po. Është shpallur pyetësori për konsultim publik dhe mendimet dhe sygjerimet do paraqiten për reflektime të mundshme në draftin final të PBA-së 2026-2028.

Pika 2: Jo.

Komisioni i Përhershëm për **“Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare”**, i mbledhur me datën 23/06/2025, shqyrtoi projekt vendimet, relacionet dhe dokumentat shoqërues në lidhje me propozimet për:

3. “Projekt-vendim (Pika 5 e rendit të ditës) “PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 NË NIVEL PROGRAMI” *propozuar nga ekzekutivi.*

1. Projekt-vendim (pika 6 e rendit të ditës) “PËR MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE NGA TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE NË VLERËN 243,812.5 LEKË DHE KRYERJEN E PAGESËS PËR KTHIMIN E SHUMËS NË PO KËTË VLERË PËR LLOGARI TË “TELEKOM ALBANIA” SH.A,(ONE TELECOMMUNICATIONS)” *propozuar nga ekzekutivi*

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

- T’i propozojë Këshillit Bashkiak, miratimin e projektakteve.

Argumentat e vendimmarrjes janë paraqitur në proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Kryetar i Komisionit

Sekretar i Komisionit

Datë 28/07/2025